



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

T. +355-4-2281650 E. luzi.l@cec.org.al, W. www.cec.org.al



Takimi i 5-të vjetor i Trupave Zgjedhore “Votimi gjithpërfshirës” - Gjeorgji, shkurt 2015-

Fjala e Kryetares Luzi; “ Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor- Sfida dhe aritje- rasti shqiptar”

PËRFSHIRJA E PERSONAVE ME AFTESI TË KUFIZUARA NË VOTIMIN GJITHPËRFSHIRËS - **ARRITJE DHE SFIDA-** - **RASTI SHQIPTAR-**

Sjellja zgjedhore e elektoratit në Shqipëri, për shkak të traditës relativisht të re të zgjedhjeve demokratike, është një element i ri në këto 25 vite demokraci. Kategoritë specifike të zgjedhësve sic janë personat me aftësi të kufizuara, kushtëzohen në sjelljen e tyre zgjedhore nga faktorë të ndryshëm, të cilët reflektojnë problematika të një demokracie në zhvillim.

Pavarësisht përmirësimit shumë të ndjeshëm të kuadrin ligjor dhe atij institucional në mbrojtje të të drejtave të kësaj kategorie në procesin zgjedhor, realiteti dëshmon ende sfida, për përballjen e të cilave nuk mjaftojnë vetëm garancitë ligjore, por kërkohet më shumë vullnet, përkushtim dhe bashkëpunim institucional, dhe në aspekte të caktuara edhe përmirësime të ligjit zgjedhor.

KQZ e Shqipërisë, me përgjegjshmëri nuk është mjaftuar vetëm me përshtatjen dhe zbatimin e programeve të veçanta për këtë kategori zgjedhësish, si parakusht për minimizimin e ndikimeve negative, por ka ndërmarrë veprime dhe inisiativa për diskutim gjithpërfshirës të problematikave, me qasje edhe propozime konkrete për përmirësimin e ligjit zgjedhor.

1. Zgjedhësit më aftësi të kufizuara në votimin gjithpërfshirës

Kushtetuta e Shqipërisë, ratifikimi nga Parlamenti Shqiptar i Konventës së OKB-së “Per te Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, ligji të tjera, janë një kuadër i plotë që sanksionojnë respektimin e të drejtave të komunitetit PAK, ndër to edhe ushtrimin e të drejtës së votës në mënyrë vetjake, të lirë dhe të fshehtë.

Në Shqipëri 4.2% e popullsisë që gëzon të drejtën e votës janë persona me aftësi të kufizuara, të cilët kanë statusin e personave që nuk flasin, nuk shikojnë, tetraplegjikët e paraplegjikët, të dëmtuarit fizikë, invalidët e punës etj. Megjithë ndërgjegjësimin gjithnjë e më shumë të këtyre votuesve se përmes votës ata mund të ndikojnë në ndryshime që lidhen direkt me përmirësime sociale për ta, edhe pse ka një vëmëndje të shtuar qeveritare dhe angazhim institucional e shoqëror për krijimin për akses sa më të plotë në votime të kësaj kategorie zgjedhësish, eksperiencat zgjedhore ende dëshmojnë pengesa që e bëjnë të mundimshme ose jo në pak raste e vështirësojnë pothuaj deri në pamundësi përfshirjen e këtij kontigjenti në votim.

Ligji zgjedhor ka shënuar progres duke zëvendësuar votimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara nëpërmjet shoqëruesit, me alternativën për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në votime për zgjedhësit me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim. Por garancitë e ligjit nuk përkthehen në garanci “de facto”. Zgjedhësi me aftësi të kufizuara për të kërkuar kushte lehtësuese në votim, e drejtës e njohur

*Takimi i 5-të vjetor i Trupave Zgjedhore “Votimi gjithpërfshirës”
- Gjeorgji, shkurt 2015-*

Fjala e Kryetares Luzi “ Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor- Sfida dhe aritje- rasti shqiptar”

nga ligji për ta, duhet t'i drejtojnë kërkesë, bashkë me dokumentacionin zyrtar që provon paaftësinë, kryetarit të qeverisjes vendore. Ky i fundit ka kompetencën ligjore për t'i regjistruar si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë. A është i duhuri, përse shërben ky mekanizëm ligjor? Njësitë vendore, administrojnë të gjithë dokumentacionin e pafatësisë së personave PAK, pasi bëjnë shpërndarjen e ndihmës sociale për ta. Kërkimi i lehtësive në votim, nëpërmjet kësaj rruge që përcakton ligji, përbën shkak për ta kufizuar edhe më tepër aftësinë/mundësinë e këtyre personave.

Përballjen e parë reale me problematikat/mungesat e kushteve lehtësuese për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, e pata sapo u mandatova në detyrën e Kryetares së KQZ-së, kohë e cila përkonte me përgatitjen për procesin zgjedhor të vitit 2013. Në takim me përfaqësuesit e disa prej shoqatave që mbrojnë të drejtat e tyre, mu adresuan kërkesa legjitime të cilat në pamje të parë ishin më se të realizueshme. Ajo që kuptova me kalimin e kohës ishte se krijimi i kushteve të përshtatshme për votim për personat me aftësi të kufizuar, nuk varej vetëm nga puna, përkushtimi dhe angazhimi i KQZ-së.

1. Nuk ishin të identifikuar qendrat e votimit ku do të votonin zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Ky ishte problemi i parë për të parashikuar dhe ndërmarrë hapat e duhur për krijimin e kushteve lehtësuese për ta. Për herë të parë KQZ, në komunikim insistues me të gjitha organet e qeverisjes vendore, ndërtoi një bazë të dhënash se sa janë dhe ku votojnë zgjedhësit PAK – sidomos 2 kategoritë kryesore: personat para/tetraplegjikë dhe zgjedhësit e verbër.

2. Problemi i dytë ishte mungesa e përshtatjes së hyrjes në shumicën e ndërtesave publike ku ishin qendrat e votimit që do të votonin zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Mbi 90% e qendrave të votimit të vendosura në objekte publike, si shkolla apo qendra spitalore, në pjesën më të madhe nuk kanë rampa, dhe nuk ofrojnë akses pasi mungojnë deri edhe vendet e parkimit pranë tyre.

Papërshtatshmëria për hyrje e ndërtesave publike për zgjedhësit PAK është problem thelbësor për arritjen e barazisë së kësaj kategorie në procesin e votimit. KQZ bëri përpjekje maksimale për të gjetur ekuilibrin ndërmjet mundësive financiare institucionale të kufizuara, dhe problemeve faktike. Falë mbështetjes së shumë donatorëve, duke shfrytëzuar në maksimum burimet financiare dhe njerëzore në dispozicion, në bazë edhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të nënshkruar me Këshillin Kombëtar të Shoqatave të Personave me Aftësi të Kufizuar, u arrit të realizohej një pjesë e konsiderueshme e kërkesave të kësaj kategorie zgjedhësish:

- Ju kërkua me insistim të gjithë kryetarëve të organeve të qeverisjes vendore që qendrat e votimit në të cilat ishin të regjistruar zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë të vendoseshin detyrimisht në katet e para të objekteve – por ky detyrim fatkeqësisht nuk u zbatua në të gjitha rastet;
- Falë ndihmës së donatorëve u pilotua për herë të parë projekti i ndërtimit të rampave të përhershme në shkollët e objekteve publike të QV-ve në tre bashki të vendit. U vendos, që fondet të shpenzoheshin për zgjidhje afat gjata, duke ndërtuar rampa të përhershme. Në proceset përendëse KQZ kishte prodhuar një kontigjent rampash druri, të cilat duke mos i rezistuar kohës, nuk mund të konsideroheshin zgjidhje e problemit;
- Ju dha hapësirë punësimi një profesionisteje shumë të mirë nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuar, falë ideve të së cilës u arrit të zbatohesh një strategji efektive informimi, sensibilizimi dhe edukimi qytetar për këtë kategori zgjedhësish;
- U trajnuan komisionerët zgjedhorë për rastet dhe format e ndihmës për të mundësuar hyrjen e votuesve PAK në qendrën e votimit;
- Në fushatën televizive për edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve u përfshi gjuha e shenjave, për të ndihmuar personat që nuk flasin dhe dëgjojnë për të kuptuar procedurat e votimit në qendrën e votimit;
- Me keqardhje më duhet të pohoj se KQZ nuk arriti të prodhojë maska me shkrimin "brail" për zgjedhësit e verbër. Përmbajtja e fletës së votimit me emrat e subjekteve garuese merr formë

Takimi i 5-të vjetor i Trupave Zgjedhore "Votimi gjithpërfshirës"

- Gjeorgji, shkurt 2015-

Fjala e Kryetares Luzi "Përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor- Sfida dhe aritje- rasti shqiptar"

përfundimtare 40 ditë para datës së zgjedhjeve, kohë e cila është e pamjaftueshme për zbatimin e procedurave ligjore administrative për prokurimin dhe prodhimin e maskave me shkrimin "brail". Këtu rendis edhe vështirësitë teknike për shkak të përmbajtjes dhe përmasave të fletës së votimit të cilat në zgjedhjet 2013, me 66 parti politike garuese rezultuan jashtë çdo lloj parashikimi. Personalisht, si Kryetare e KQZ-së i kam kërkuar ndjesë publike çdo zgjedhësi të kësaj kategorie sociale që nuk pati mundësi të ushtrojë vetë të drejtën e votës për këtë shkak.

Eksperienca e organizimit të zgjedhjeve të 2013 ripërsëriti një mësim që institucionalisht në Shqipëri po e "mësojmë" me vështirësi: ushtrojmë aftësi të kufizuara institucionale në garantimin e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara! Pavarësisht se dispozitat ligjore që Kodi Zgjedhor i ka kushtuar garantimit të kushteve për zgjedhësit PAK, i japin KQZ-së më tepër rolin e rregullatorit të këtij procesi në rast të konstatimit të kushteve të papërshtatshme të qendrave të votimit, institucioni ka bërë përpjekje maksimale për shmangien e zgjidhjes së minutës së fundit.

KQZ menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 2013, organizoi një tryezë teknike pune me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve, organizatave ndërkombëtare dhe grupeve të interesit, të cilët kanë përgjegjësi, bashkëpunojnë apo kontribuojnë në shmangien e barrierave për personat me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Kjo tryezë kishte për qëllim shprehjen e interesit dhe qëndrimet e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të përbashkëta dhe identifikimin e mënyrave, mjeteve dhe teknikave për të garantuar në të ardhmen e afërt kushtet për ushtrimin e lirë të së drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuara. Gjetjet dhe përfundimet e kësaj Tryeze, sa i përket mundësive për përmirësime të Kodit Zgjedhor për garantimin e kushteve të votimit për zgjedhësit PAK, KQZ ja ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë. Rekomandimet më kryesore për ndryshime/përmirësime të Kodit Zgjedhor kishin të bënin me :

1. Harmonizimin e tij me frymën e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
2. Përcaktimin si dispozitë urdhëruese dhe jo si zgjidhje alternative detyrimin e pushtetit vendor për të garantuar infrastrukturën ndihmëse në çdo qendër votimi ku janë të regjistruar zgjedhës që nuk mund të votojnë vet. Përbushja e detyrimit duhet të monitorohet nga KQZ, e cila duhet të ketë në dispozicion mekanizma ligjorë, që ti japin mundësi të marrë masa administrative ndaj drejtuesve të pushtetit vendor, të cilët nuk i përgjigjen kërkesave të ligjit dhe autoritetit monitorues;
3. Përcaktimin në dispozita të veçanta të tij të sanksioneve ndaj pushtetit vendor, në rast të mosrespektimit të ligjit dhe detyrimeve për garantimin e kushteve për ushtrimin e të drejtës së votës nga Personat me Aftësi të Kufizuara;
4. Kodi Zgjedhor duhet të shprehet për të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara intelektuale (PAKI), i cili vazhdon të mbetet një problem i lënë në heshtje dhe që në fakt nuk ka patur raste të kufizimit. Në këtë këndvështrim, Kodi Zgjedhor duhet të specifikojë mënyrat dhe nevojat për përshtatshmëri duke ju referuar nocioneve/llojit të paaftësisë dhe jo të përgjithësuar;
5. Të përcaktohen ndarje të përgjegjësive institucionale për përgatitje të listave të personave që nuk mund të votojnë vet, për të shmangur hapësirat për abuzime procedurale. Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë që në propozimet dhe vendimmarrjen institucioneve publike (sidomos pushtetit vendor) të cilat kanë përgjegjësi problematikën e personave me aftësi të kufizuara, të ketë edhe përfaqësim të shoqatave të PAK;
6. Kuvendi i Shqipërisë duhet që të marrë në konsideratë dhe të bëjë pjesë të procesit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor edhe përfaqësuesit e Grupit të Interesit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët, për shkak të përvojës dhe ekspertizës mund të ofrojnë zgjidhje ligjore dhe teknike shumë më efektive.

Duke pritur me besim se Kuvendi i Shqipërisë do t'i materializojë këto propozime të përcjella nga KQZ, që bëjnë bashkë aktorë e faktorë të fushës, patëm kënaqësinë të marrin vlerësimin dhe

*Takimi i 5-të vjetor i Trupave Zgjedhore "Votimi gjithpërfshirës"
- Gjeorgji, shkurt 2015-*

Fjala e Kryetares Luzi "Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor- Sfida dhe aritje- rasti shqiptar"

falenderim për punën dhe përkushtimin institucional nga shoqatat e personave PAK. Ky falenderim i sinqertë na impenjon për të ardhmen, për tu angazhuar më shumë për këtë kategori, jo vetëm si detyrim institucional, por si mision qytetar!

Është bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mirëqenies Sociale, me pushtetin vendor, duke kërkuar vëmendje institucionale dhe marrjen e masave në kohë për përshtatshmërinë ndërtimore për personat PAK të objekteve publike që kanë në administrim të cilat shërbejnë si qendra votimi. Për këtë qëllim, të gjithë institucioneve i është dërguar kohë pas kohe lista e plotë të objekteve në administrim të cilat shërbejnë si qendra votimi për zgjedhësit PAK, me numrin dhe llojin e paaftësisë. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e Grupeve të Interesit të personave me aftësi të kufizuara, të cilët, për shkak të përvojës dhe ekspertizës mund të ofrojnë zgjidhje teknike shumë më efektive të problemeve.

Jemi optimistë se në zgjedhjet e qershorit 2015 do të sigurojmë maskën në alfabetin "brail" për personat që nuk shikojnë, pavarësisht specifikave teknike, si dhe faktit që në këto zgjedhje do të votohet me dy fletë votimi. Janë evidentuar paraprakisht kompanitë që mund ta ofrojnë prodhimin e maskave për zgjedhësit e verbër brenda kohës së limituar, duke bërë prezent çdo vështirësi apo "të papritura" që procesi mund të sjellë.

Në 5 Shkurt 2015, KQZ për herë të parë në Shqipëri organizoi festimet e Ditës Botërore të Zgjedhjeve. Axhenda e veprimtarive të kësaj dite, një sesion i veçantë i kushtonte Personave me Aftësi të Kufizuara. Anëtarë të Forumit Rinor të personave PAK, prezantuan për të pranishmit aspiratat dhe vendosmërinë e tyre, që pavarësisht nga pengesat objektive, apo subjektive sikundër papërshtatshmëria e objekteve që shërbejnë si qendra votimi për këtë grupim, të bëjnë të gjitha përpjekjet për të mundësuar që çdo individ të këtij grupimi t'i krijohen kushtet e përshtatshmërisë për të ushtruar të drejtën e votës në mënyrë individuale. Në këtë përpjekje, të rinjtë PAK shprehën vlerësimin e tyre për vëmendjen, përkushtimin dhe punën që KQZ, sikundër dhe organizmat ndërkombëtarë kanë treguar për shmangien e barrierave për ta në procesin e votimit, me qëllim që edhe ata ta kryejnë aktin e votimit barazisht si të gjithë zgjedhësit e tjerë.

Për herë të parë për zgjedhjet lokale të 2015, në 24 Zyrat Zgjedhore që ngrihen në 12 qarqet e vendit do të angazhohen persona PAK, detyra e të cilëve do të jetë ndjekja e problemeve të këtij komuniteti, evidentimi në kohë i çdo problematike, me qëllim marrjen e menjëhershme të masave për zgjidhjen e saj. Si përsëritje e përvojës pozitive, KQZ sërish do të angazhojë persona PAK për fushatën edukuese zgjedhore për zgjedhjet e 21 qershorit, me qëllim që çdo material i prodhuar të "flasë" në gjuhën e tyre, t'i përgjigjet çdo pyetje të tyre për informacion. Të gjitha këto veprime të ndërmarra më bëjnë të jem optimiste, se në zgjedhjet e qershorit 2015, KQZ do të jetë më pranë zgjedhësve PAK, do të arrijë të minimizojë pengesat sidomos për ata që nuk shikojnë dhe para-tetra plegjikët.